

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/____

PËR POLICINË BASHKIAKE

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Ky ligj rregullon misionin, organizimin, funksionimin, kompetencat e Policisë Bashkiake në Republikën e Shqipërisë dhe marrëdhëniet e punës së punonjësit të Policisë Bashkiake.

Neni 2 Misioni

Policia Bashkiake krijohet me qëllim të ushtrimit të funksioneve në shërbim të sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, në mbarrëvajtjen e punëve publike, mirëadministrimit të hapësirave publike në territorin e juridiksionit të saj, zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe akteve të nxjerra nga organi përfaqësues dhe ekzekutiv i bashkisë.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Policia Bashkiake” është strukturë e administratës së bashkisë si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore;
- b) “Organi përfaqësues dhe ekzekutiv i bashkisë” janë kryetari i bashkisë dhe këshilli bashkiak referuar legjislacionit për vetëqeverisjen vendore;
- c) “Ministri përgjegjës” është ministri që mbulon fushën e përgjegjësisë për çështjet vendore;
- ç) “Rregullorja kuadër” është rregullorja, e cila parashikon organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake;
- d) “Normat mbi bashkëjetesën shoqërore” janë tërësia e rregullave që përcaktojnë sjelljen, marrëdhënien e individëve në shoqëri, me qëllim ruajtjen e ekuilibrave të bashkëjetesës,

nëpërmjet zbatimit të rregullave sociale, mbrojtjes së lirive e të drejtave të njeriut, sigurisë së jetës dhe veprimtarive të përditshme ekonomike e shoqërore, përfshirë këtu edhe bashkëpronësinë në ndërtesat e banimit, si dhe rregullat që kanë të bëjnë me ndalimin e mbajtjes së disa kafshëve në qendrat urbane;

- dh) “Hapësirat publike” janë hapësirat, si trotuare, rrugë, sheshe, lulishte, parqe, shëtitore, shesh pushime shkalle në pallate, rrugëkalime e mjedise të tjera në përdorim publik, që janë të pacënueshme dhe si rregull nuk mund të ndryshojnë destinacionin e tyre në shërbim të përdorimit publik;
- e) “Emërimi i punonjësit të Policisë Bashkiake” është akti i fillimit të marrëdhënieve juridike të punës për punonjësin e Policisë Bashkiake;
- ë) “Drejtuesi i Policisë Bashkiake” është autoriteti më i lartë ekzekutiv dhe organizativ i Policisë Bashkiake dhe përgjigjet drejtpërdrejtë para Kryetarit të Bashkisë për realizimin e detyrave dhe objektivave të përcaktuara;

Neni 4

Parimet e veprimtarisë

Parimet bazë që udhëheqin Policinë Bashkiake në veprimtarinë e saj, janë:

- a) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- b) ligjshmëria;
- c) mosdiskriminimi;
- ç) proporcionaliteti;
- d) paanshmëria;
- dh) integriteti;
- e) merita dhe profesionalizmi;
- ë) transparenca;
- f) kontrolli dhe llogaridhënia.

KREU II

STATUSI, JURIDIKSIONI, SIMBOLET DHE UNIFORMA

Neni 5

Statusi dhe juridiksioni

1. Policia Bashkiake është institucion i administratës vendore, pjesë e strukturës së bashkisë.
2. Policia Bashkiake është strukturë e depolitizuar.
3. Policia Bashkiake ushtron veprimtarinë në territorin e bashkisë përkatëse.

Neni 6

Simbolet dhe uniforma

1. Këshilli Bashkiak miraton stemën e Policisë Bashkiake sipas bashkisë përkatëse.
2. Policia Bashkiake në çdo bashki ka uniformë të njëjtë, të ndryshme nga çdo strukturë tjetër policore. Uniforma dhe elementët e saj miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Punonjësi i Policisë Bashkiake detyrohet të përdorë uniformën dhe simbolet e saj gjatë kryerjes së detyrës vetëm për qëllimin e përcaktuar, në përputhje edhe me rregulloren kuadër.
4. Punonjësi i Policisë Bashkiake, gjatë kryerjes së detyrës identifikohet me dokumentin individual të identifikimit, sipas modelit të përcaktuar në rregulloren kuadër.

KREU III

ORGANIZIMI, FUNKSIONIMI DHE KOMPETENCAT

Neni 7

Struktura

1. Kryetari i Bashkisë miraton strukturën dhe organikën e Policisë Bashkiake në përputhje me këtë ligj.
2. Këshilli i Ministrave miraton me vendim rregulloren kuadër për organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake.
3. Policia Bashkiake organizohet si rregull në drejtori dhe sektorë, të detajuara në rregulloren kuadër.
4. Ministri përgjegjës përcakton me udhëzim numrin e punonjësve të Policisë Bashkiake, duke e përlogaritur në referim të popullsisë faktike dhe sipas specifikimeve që i nevojiten çdo bashkie.

Neni 8

Detyrat dhe kompetencat e Policisë Bashkiake

Policia Bashkiake ka këto detyra dhe kompetenca kryesore:

- a) siguron zbatimin e akteve të nxjerra nga kryetari i bashkisë dhe këshilli bashkiak;
- b) siguron zbatimin e urdhrave të nxjerra nga kryetari i bashkisë, që kanë të bëjnë me personat juridikë e fizikë, të cilët nuk plotësojnë detyrimet ligjore, fiskale, apo çdo detyrim tjetër pasuror;
- c) parandalon, konstaton dhe shqyrton kundërvajtjet administrative në zbatim të akteve të njësive të vetëqeverisjes vendore brenda territorit të juridiksionit të saj dhe në përputhje me përcaktimet ligjore;
- ç) njofton dhe mbështet në rast marrje njoftimi apo konstatimi të punimeve ndërtimore pa leje, strukturën përgjegjëse për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave ligjore;
- d) merr masa për ruajtjen e objekteve në pronësi të bashkisë si dhe të atyre që administrohen nga ana e saj;
- dh) merr masa për të siguruar lirin e hapësirave publike;
- e) merr masa për zbatimin e akteve të organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore që përcaktojnë oraret e shërbimit të njësive tregtare, bar-kafeve, restoranteve, dhe të gjithë subjekteve të tjera me veprimtari publike;
- ë) merr masa për ruajtjen e afisheve, njoftimeve e shpalljeve publike si dhe heqjen e atyre të paligjshme ose të paautorizuara;
- f) merr masa të sigurisë për zbatimin e planit të emergjencës së bashkisë për parandalimin e fatkeqësive të ndryshme natyrore, si dhe bashkëpunon me Komisionin e Mbrojtjes Civile pranë bashkisë dhe Prefektit të Qarkut për kapërcimin e tyre;
- g) kontrollon zbatimin e rregullave të qarkullimit rrugor në territorin e juridiksionit të saj, sipas parashikimeve në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, si dhe sipas parashikimeve të marrëveshjeve të bashkëpunimit që lidhen me Policinë e Shtetit;
- gj) bashkëpunon me Policinë e Shtetit për mbikëqyrjen e sigurisë, brenda territorit të juridiksionit të saj;
- h) bashkërendon masat me Policinë e Shtetit, për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike në raste të aktiviteteve, në territorin e juridiksionit të bashkisë;
- i) njofton strukturat përkatëse, kur konstaton ndotje akustike, për matjen e nivelit të zhurmave dhe për vazhdimin e procedurave të tjera ligjore;

- j) merr masat e duhura duke bashkëpunuar me strukturat përkatëse të bashkisë dhe ato jashtë saj për të garantuar mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet;
- k) konstaton kundërvajtje dhe zbaton sanksione për mosrespektim të normave mbi bashkëjetesën shoqërore të përcaktuara në aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, për faktet e konstatuara brenda territorit të juridiksionit të saj.

Neni 9

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative janë të parashikuara në ligjet e veçanta dhe aktet e këshillit bashkiak.
2. Policia Bashkiake për shkeljet e konstatuara në kompetencë të saj, merr masa administrative bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore për kundërvajtjet administrative.
3. Kur Policia Bashkiake krijon dyshimin e arsyeshëm se një veprim ose mosveprim i një personi fizik ose juridik, përbën një kundërvajtje administrative, konstatimi dhe shqyrtimi i së cilës nuk është në kompetencën e saj dhe se nga ai veprim mund të shkaktohet një dëm i pariparueshëm dhe me pasoja të rënda ndaj interesit publik apo palëve të treta, për jetën apo shëndetin e njerëzve, kafshëve apo për mjedisin, punonjësi i strukturës konstatuese ka të drejtë të marrë masa për ndërprerjen e menjëhershme të veprimeve të kundërvajtësit dhe të njoftojë organin përkatës për shkeljen e konstatuar.

Neni 10

Kryetari i bashkisë

Kryetari i bashkisë ka këto detyra dhe kompetenca:

- a) propozon në këshillin bashkiak buxhetin dhe strukturën për këtë shërbim;
- b) siguron mjetet dhe infrastrukturën e nevojshme për Policinë Bashkiake;
- c) nxjerr vendime, urdhëresa dhe urdhra në zbatim të vendimeve të Këshillit Bashkiak;
- ç) kontrollon dhe analizon veprimtarinë e Policisë Bashkiake duke marrë masa për përmirësimin e veprimtarisë së saj;
- d) paraqet pranë këshillit bashkiak, çdo vit ose kurdo që është e nevojshme, informacion në lidhje me funksionimin e Policisë Bashkiake;
- dh) organizon konsultime periodike me komunitetin, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të strukturave vendore të Policisë së Shtetit dhe të organizatave jofitimprurëse, lidhur me prioritetet dhe veprimtarinë e Policisë Bashkiake;
- e) miraton kalendarin e kualifikimeve apo rikualifikimeve të stafit të Policisë Bashkiake, sipas propozimit të drejtuesit të Policisë Bashkiake;
- ë) vepron si organ epror në procesin e ankimeve administrative ndaj akteve të Policisë Bashkiake.

Neni 11

Këshilli bashkiak

Këshilli bashkiak ka këto kompetenca:

- a) miraton rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Policisë Bashkiake, në përputhje me përcaktimet e rregullores kuadër;
- b) miraton buxhetin dhe strukturën për këtë shërbim, për funksionimin e Policisë Bashkiake.

KREU IV

STRUKTURAT DREJTUESE TË POLICISË BASHKIAKE

Neni 12

Detyrat e drejtuesit të Policisë Bashkiake

Drejtuesi i Policisë Bashkiake:

- a) organizon, drejton, kontrollon dhe përgjigjet për sigurimin e zbatimit të detyrimeve që ka Policia Bashkiake;
- b) koordinon veprimtarinë e punës me Policinë e Shtetit, për zbatimin e detyrimeve, të akteve ligjore dhe nënligjore, në fushën e rendit e të sigurisë publike në parandalimin e veprimtarive të kundërligjshme për aktivitetet që zhvillohen në territorin e bashkisë;
- c) planifikon aktivitetin në mbështetje të detyrave të caktuara për të siguruar realizimin në kohë të objektivave të përcaktuara;
- ç) kryen analiza, raporte, përshkrime që lidhen me veprimtarinë e Policisë Bashkiake;
- d) propozon te Kryetari i Bashkisë kalendarin e trajnimeve, për të siguruar kualifikimin periodik profesional në Akademinë e Sigurisë, në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike ose në institucione të tjera publike, të punonjësve të Policisë Bashkiake;
- dh) këshillon Kryetarin e Bashkisë dhe jep mendime për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme.

KREU V

PRANIMI, FORMIMI DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIEVE TË PUNËS

Neni 13

Pranimi në Policinë Bashkiake

1. Pranimi në Policinë Bashkiake bazohet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale dhe mosdiskriminimit. Pranimi kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhjeje dhe testimi transparent e të drejtë sipas procedurës dhe kritereve të përcaktuara për kualifikim.
2. Procesi përzgjedhës bazohet në vlerësimin e kritereve etike dhe aftësive profesionale të kandidatëve nëpërmjet konkurrimit, që përfshin një vlerësim paraprak të kritereve të kandidatit, testim fizik, testim me shkrim dhe intervistë me gojë, sipas përcaktimeve në rregulloren kuadër.

Neni 14

Kriteret e përgjithshme për pranimin në Policinë Bashkiake

Kriteret e përgjithshme për pranimin në Policinë Bashkiake, janë si më poshtë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë përfunduar arsimin e mesëm;
- c) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) ndaj tij nuk është nisur një procedim penal dhe nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtjeje penale;
- dh) të mos jetë subjekt i ndalimeve, sipas legjislacionit në fuqi për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike;
- e) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna;
- f) të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për pozicionin përkatës, të përcaktuara në rregulloren kuadër.

Neni 15
Emërimi i punonjësit të Policisë Bashkiake

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake emërohet nga kryetari i bashkisë, me propozim të komisionit përzgjedhës.
2. Pas emërimit, punonjësi i Policisë Bashkiake i nënshtrohet periudhës tre mujore të provës.
3. Punonjësi i Policisë Bashkiake, gjatë periudhës të provës, përfundon trajnimin e detyrueshëm pranë Akademisë së Sigurisë. Bashkitë bashkëpunojnë me Akademinë e Sigurisë sipas përcaktimeve në rregulloren kuadër për organizimin e trajnimit të detyrueshëm.
4. Mos përfundimi me sukses i trajnimit të detyrueshëm përbën shkak për përfundimin e marrëdhënies së punës.

Neni 16
Kriteret për emërimin e drejtuesit të Policisë Bashkiake

Kandidati për drejtues të Policisë Bashkiake, përveç kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në këtë ligj, duhet të plotësojë kriteret, si vijon:

- a) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare jashtë vendit dhe të ketë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë;
- b) të ketë të paktën 5 vjet eksperiencë pune në administratën publike.

Neni 17
Marrëdhëniet e punësimit të punonjësit të Policisë Bashkiake

Marrëdhëniet e punës së drejtuesit dhe të punonjësve të tjerë të Policisë Bashkiake rregullohen sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 18
Emërimi, lirimi dhe shkarkimi i drejtuesit të Policisë Bashkiake

1. Emërimi, lirimi dhe shkarkimi i drejtuesit të Policisë Bashkiake bëhet nga kryetari i bashkisë, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj.
2. Procedura e përzgjedhjes për drejtuesin e Policisë Bashkiake përcaktohet në rregulloren kuadër.

Neni 19
Lirimi dhe shkarkimi

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake lirohet nga detyra në rastet kur:
 - a) jep dorëheqjen;
 - b) mbush moshën e pensionit;
 - c) bëhet i paafte përgjithmonë për të kryer detyrën, për shkak të gjendjes shëndetësore.
2. Punonjësi i Policisë Bashkiake shkarkohet nga detyra kur:
 - a) dënohet me vendim gjyqësor të formës të prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - b) ndaj tij merret masa disiplinore “largim nga Policia Bashkiake”.

Neni 20
Vlerësimi i performancës

1. Vlerësimi i performancës së punonjësit të Policisë Bashkiake bëhet çdo vit, nga eprori i drejtpërdrejtë.
2. Kriteret dhe procedurat e vlerësimit përcaktohen në rregulloren kuadër.

Neni 21
Trajnimet

1. Trajnimet e punonjësit të Policisë Bashkiake bëhen në mënyrë periodike në Akademinë e Sigurisë, në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike ose në institucione të tjera publike, me qëllim përmirësimin e aftësive profesionale.
2. Kostot e trajnimit përballohen nga buxheti i bashkisë.

Neni 22
Trajtimi financiar gjatë dhe pas përfundimit të marrëdhënieve të punës

1. Paga e punonjësit të Policisë Bashkiake përbëhet nga paga për funksion, shtesa për vështirësi shërbimi dhe shtesa për vjetërsi në punë, e cila miratohet me vendim të këshillit bashkiak, brenda kufijve të caktuar nga aktet ligjore në fuqi.
2. Shpenzimet për pagat dhe shpenzimet e tjera përballohen nga buxheti i bashkisë.

KREU VI
DETYRIMET DHE KUFIZIMET KRYESORE TË PUNONJËSIT TË POLICISË
BASHKIAKE

Neni 23
Detyrimi për respektimin e ligjit

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake respekton Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si dhe mbron të drejtat e liritë e njeriut.
2. Punonjësi i Policisë Bashkiake mban përgjegjësi individuale për ligjshmërinë e çdo veprimi apo mosveprimi të tij gjatë ushtrimit të detyrës.
3. Punonjësi i Policisë Bashkiake kryen detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim dhe në përputhje me ligjin.

Neni 24
Detyrimi për të zbatuar urdhrin

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake vepron në përputhje me urdhrat e marrë nga eprorët hierarkikë, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të bashkisë.
2. Punonjësi i Policisë Bashkiake, nëse dyshon për paligjshmërinë e urdhrin të eprorit, ai nuk e zbaton atë, por informon pa vonesë eprorin e personit që ka dhënë urdhrin dhe kërkon konfirmimin e tij me shkrim.
3. Punonjësi i Policisë Bashkiake zbaton urdhrin me shkrim, me përjashtim të rastit kur zbatimi i tij përbën vepër penale.

Neni 25
Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake nuk përdor informacionin e mbledhur gjatë ushtrimit të detyrës për qëllime të tjera, jashtë atyre të përcaktuara me ligj.
2. Punonjësi i Policisë Bashkiake siguron mbrojtjen dhe mospërhapjen e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe atyre që lidhen me veprimtarinë tregtare apo profesionale të personave, të mbrojtura sipas ligjit dhe me të cilat njihet gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 26
Detyrimi për administrimin e pronës dhe kohën e punës

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake mirëadministron pronën dhe pajisjet që i vihen në përdorim në ushtrimin e detyrës dhe i përdor ato vetëm për qëllimin e përcaktuar.
2. Punonjësi i Policisë Bashkiake shfrytëzon kohën e punës dhe shërbimit me efektshmëri dhe vetëm për kryerjen e detyrave.

Neni 27
Kufizimi për veprimtari të dyta

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake nuk mund të punësohet ose të kryejë veprimtari private që bie ndesh me detyrën e punonjësit të Policisë Bashkiake.
2. Në rast të kryerjes së veprimtarive të dyta, punonjësi i Policisë Bashkiake merr miratimin me shkrim të drejtuesit të strukturës.

Neni 28
Konflikti i interesit

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake shmang çdo konflikt ndërmjet interesit të tij privat dhe interesit publik në kryerjen e detyrës sipas legjislacionit përkatës.
2. Punonjësi i Policisë Bashkiake informon menjëherë eprorin e tij në rast dyshimi për një konflikt interesi.
3. Eprori merr masa të shmangë konfliktin e interesit të deklaruar nga punonjësi.

KREU VII
DISIPLINA

Neni 29
Sjellja dhe etika

Punonjësi i Policisë Bashkiake respekton rregullat e sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave, të cilat përcaktohen në rregulloren kuadër.

Neni 30

Shkeljet disiplinore

1. Shkelje disiplinore është çdo veprim ose mosveprim i punonjësit të Policisë Bashkiake gjatë ushtrimit të detyrës apo për shkak të saj, që bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, nëse ato nuk përbëjnë vepër penale.
2. Shkeljet disiplinore kategorizohen në shkelje disiplinore të lehta dhe shkelje disiplinore të rënda.
3. Masa disiplinore duhet të jetë në përputhje me shkeljen e kryer, pasojat e ardhura prej saj dhe shkallën e fajësisë.
4. Masa e lehtë disiplinore jepet nga eprori i punonjësit të Policisë Bashkiake. Punonjësi i Policisë Bashkiake, ndaj të cilit merret masë e lehtë disiplinore, ka të drejtë të ankohet tek eprori i punonjësit që ka dhënë masën, brenda 5 ditëve nga çasti i marrjes dijeni me shkrim, për dhënien e masës disiplinore.
5. Masa e rëndë disiplinore për punonjësit e Policisë Bashkiake jepet nga komisioni i disiplinës, me propozim të drejtuesit të Policisë Bashkiake.
6. Gjatë procesit të ankimit, punonjësit të Policisë Bashkiake i garantohet e drejta për t'u informuar, dëgjuar dhe mbrojtur, në përputhje me parimet e Kodit të Procedurave Administrative.
7. Punonjësi i Policisë Bashkiake ka të drejtë të ankimojë vendimin e dhënë, sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 31

Masat disiplinore

1. Ndaj punonjësit të Policisë Bashkiake që kryen shkelje disiplinore, merren këto masa:
 - a) Për shkelje të lehta disiplinore:
 - i) vërejtje;
 - ii) vërejtje me paralajmërim.
 - b) Për shkelje të rënda disiplinore:
 - i) mbajtja deri në 1/4 e pagës së plotë për një periudhë deri në tre muaj;
 - ii) largimi nga Policia Bashkiake.
2. Masa disiplinore shuhet pas kalimit të këtyre afateve:
 - a) 6 muaj për masën e vërejtjes dhe vërejtjes me paralajmërim;
 - b) 3 vjet nga njoftimi i masës së parashikuar sipas shkronjës “b”, të pikës 1.
3. Deklarimi i shuarjes bëhet kryesisht apo me kërkesë, me vendim të njësisë së burimeve njerëzore të bashkisë dhe masa fshihet nga dosja e personelit.
4. Llojet e shkeljeve disiplinore, kriteret, rregullat, procedurat për dhënien e masave disiplinore, si dhe përbërja, organizimi dhe funksionimi i Komisioni të Disiplinës përcaktohen në rregulloren kuadër.

KREU VIII

PAJISJET DHE AUTOMJETET

Neni 32

Pajisjet dhe përdorimi i tyre

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake nuk mban armë për shkak të detyrës.
2. Punonjësit të Policisë Bashkiake i jepen në përdorim mjete dhe pajisje të tjera të përcaktuara në rregulloren kuadër.

Neni 33

Automjetet e Policisë Bashkiake

Policia Bashkiake gjatë ushtrimit të detyrës përdor edhe automjete. Këshilli i Ministrave miraton me vendim ngjyrën, shenjën dhe përdorimin e tyre.

KREU IX

MASAT PËR RUAJTJEN E RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE NË KOMUNITET

Neni 34

Kontrolli i identitetit

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake kontrollon identitetin e personit kur:
 - a) në gjendjen e flagrancës, konstatohet se po kryen një kundërvajtje administrative;
 - b) ndaj të cilit Policia Bashkiake ndërhyr për të përmbushur detyrat e saj;
 - c) është paraqitur një kërkesë me dyshimin se është kryer një shkelje administrative;
 - ç) është i dyshuar për cënim të rendit dhe sigurisë publike.
2. Punonjësi i Policisë Bashkiake për identifikimin e personit, bazohet në dokumentet ligjore të identifikimit.
3. Policia Bashkiake, gjatë procedurës së verifikimit, ka të drejtë të kërkojë ndihmën e Policisë së Shtetit për kontrollin e identitetit të personit të dyshuar për kryerjen e kundërvajtjes apo shkeljes së konstatuar.

Neni 35

Bllokimi i rrugëve

Për nevoja të rendit dhe të sigurisë publike ose në rastet e fatkeqësive natyrore apo të aksidenteve, Policia Bashkiake vë në dispozicion të Policisë së Shtetit, punonjësit e saj dhe mjetet, për bllokimin e një pjese të rrugëve ose të mjediseve publike brenda juridiksionit të bashkisë deri në kryerjen e veprimeve të nevojshme ligjore.

Neni 36

Sekuestrimi dhe konfiskimi i sendeve

1. Në rastin e shkeljeve të konstatuara në zënien e paligjshme të hapësirave publike nga persona fizikë ose juridikë, Policia Bashkiake kryen sekuestrimin dhe konfiskimin e sendeve sipas përcaktimeve ligjore për kundërvajtjet administrative.
2. Punonjësi i Policisë Bashkiake harton procesverbalin përkatës, i cili i jepet për njohje pronarit ose poseduesit të sendeve nëse identifikohet.
3. Sendet e sekuestruara konfiskohen pas kalimit të afatit të ankimit ndaj aktit administrativ që vendos masën e dënimit për kundërvajtjen administrative, ose pasi vendimi i gjykatës për lënien në fuqi të aktit administrativ të ketë marrë formë të prerë.
4. Sendet e konfiskuara shiten në ankand ose shkatërrohen për shkak të natyrës së tyre. Të ardhurat e tyre nga procesi i shitjes me ankand kalojnë në buxhetin e bashkisë.
5. Bashkitë i depozitojnë sendet e sekuestruara dhe të konfiskuara, në ambiente të posaçme.

6. Sendet e sekuestruara i kthehen pronarit ose poseduesit, pasi të jetë shlyer detyrimi për masën administrative të vendosur. Nëse pronari ose poseduesi i sendit nuk mund të identifikohet ose nuk kërkon me dëshirën e tij kthimin e sendit, sendi i sekuestruar kalon në pronësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Procedurat e sekuestrimit, konfiskimit dhe shkatërrimit të sendeve përcaktohen në rregulloren kuadër.

Neni 37

Masat mbrojtëse

1. Masat mbrojtëse merren ndaj personit me çrregullime të shëndetit mendor, në gjendje të dehur, nën efektet e lëndëve narkotike ose ndaj personit me sëmundje infektive të dukshme. Në këto raste, punonjësi i Policisë Bashkiake njofton strukturën përkatëse dhe në rast urgjence dërgon personin në institucionet shëndetësore.
2. Punonjësi i Policisë Bashkiake informon menjëherë Policinë e Shtetit për marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e personit, gjendja e të cilit tregon qartë se nuk mund të kontrollojë veprimet dhe sjelljen e tij dhe për këtë arsye mund t'i shkaktojë dëmtime fizike ose të përbëjë rrezik për jetën e tij ose të tjerëve.
3. Veprimet e mësipërme për marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të parashikuar në këtë dispozitë, dokumentohen në procesverbal.

Neni 38

Bashkërendimi me strukturat ligjzbatuese

1. Policia Bashkiake bashkëpunon dhe bashkërendon punën me institucionet e administratës publike, personat juridikë dhe fizikë, në përmbushje të detyrave funksionale të përcaktuara edhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore.
2. Policia Bashkiake bashkërendon punën me Policinë e Shtetit në drejtim të shkëmbimit të informacionit, në funksion të parandalimit të krimit në bashkinë përkatëse.

Neni 39

Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake

Bazuar në rregulloren kuadër, çdo bashki miraton rregulloren e Policisë Bashkiake brenda juridiksionit të saj territorial.

KREU X

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 40

Aktet nënligjore zbatuese

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 6, pika 2, nenit 7, pika 2 dhe nenit 33 brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.
2. Ngarkohen këshillat bashkiakë të nxjerrin aktet rregullatore pas miratimit të Rregullores Kuadër.
3. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet vendore të nxjerrë aktin nënligjor, në zbatim të nenit 7, pika 4, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 41
Shfuqizime

Ligji nr. 8224, datë 15.05.1997 “*Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës*”, të ndryshuar dhe akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e Policisë Bashkiake dhe që bien ndesh me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 42
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
LINDITA NIKOLLA